



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 764/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës Nr. 1514 prot., datë 20.09.2018, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF- 84882-09-06-2018, me objekt “Blerje dhe Instalim kamerash në objektet shkollore, cerdhe, kopshtet dhe rrugët e kryqëzimet kryesore të qytetit”, me fond limit 2,340,500 lekë pa tvsh, publikuar më datë 07.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Ankimues:

“Elektrosek” shpk
Adresa: Rruga “Kavajës”, Pallati 100 Vitrina, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor

Bashkia Librazhd
Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:
I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.09.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF- 84882-09-06-2018, me objekt “*Blerje dhe Instalim kamerash në objektet shkollore, cerdhe, kopshtet dhe rrugët e kryqëzimet kryesore të qytetit*”, me fond limit 2,340,500 lekë pa tvsh, publikuar më datë 07.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

II.2. Në datën 11.09.2017 operatori ekonomik “*Elektrosek*” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.2.1. Në datën 13.09.2018 me shkresën nr. 4556/1 prot, operatori ekonomik ankimues “*Elektrosek*” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së tij nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd.

II.2.2. Në datën 20.09.2018 operatori ekonomik ankimuese “*Elektrosek*” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. 4876/1 prot, datë 28.09.2018, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1514/2 prot, datë 01.10.2018, me objekt “*Dërgohet dokumentacioni dhe informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Elektrosek*” shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4. Në datën 12.11.2018 operatori ekonomik ankimues “*Elektrosek*” shpk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr. REF- 84882-09-06-2018, me objekt “*Blerje dhe Instalim kamerash në objektet shkollore, cerdhe, kopshtet dhe rrugët e kryqëzimet*”

kryesore të qytetit”, me fond limit 2,340,500 lekë pa tvsh, publikuar më datë 07.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Elektrosek” shpk për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF- 84882-09-06-2018, me objekt “Blerje dhe Instalim kamerash në objektet shkollore, cerdhe, kopshtet dhe rrugët e kryqëzimet kryesore të qytetit”, me fond limit 2,340,500 lekë pa tvsh, publikuar më datë 07.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “ Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri.

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Elektrosek” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF- 84882-09-06-2018, me objekt “Blerje dhe Instalim kamerash në objektet shkollore, cerdhe, kopshtet dhe rrugët e kryqëzimet kryesore të qytetit”, me fond limit 2,340,500 lekë pa tvsh, publikuar më datë 07.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1514 Protokolli, Datë 20.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha